

VENDIM
Nr.110, datë 17.2.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS PERONDI, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Perondi të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 232 (dyqind e tridhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1 529 (një mijë e pesëqind e njëzet e nëntë).

2.Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Perondi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Perondi
nr.1

Lidhja

21-23	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	në pronësi
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	në pronësi
62-70	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	në pronësi
14-20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	në pronësi
71-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	në pronësi
29-60	Varrezat publike	në pronësi
93-113,142,144,145,153,159 (Vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	në përdorim
26-28	Prona që përdoren për ushtrimin e	në pronësi

	funksiioneve në fushën e shërbimit social.	
376-448,392-882,887-903,908-1285	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	në pronësi
331	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	në pronësi
93-113,142,144,145,153,159-163, (Vetëm trojet e zëna), 118-121,125-141,143,146-152,154-158,164	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	në pronësi
1286-1288,1291-1294,1296-1299,1301,1303-1305	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	në përdorim
1289,1290,1295,1300,1302,1306,1473-1529	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	në pronësi